


Qendres qe kerkon

r Tirane

GJYQTARE
MARINELA OSMANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

NR.REGJ.THEM. 412
DATE REGJISTRIMI 04.06.2018

NUMER VENDIMI 587/9
DATA 26.06.2018

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË, E PERBERE NGA:
MARINELA OSMANI – GJYQTARE

Sot me date 26.06.2018, mori ne shqyrtim kerkesen, qe i perket:


- KERKUES:** Shoqata “Agjencia Albautor”, perfaqesuar nga Erlir Puto, ne cilesine e Drejtorit te Pergjithshem.
- OBJEKTI:** Depozitimim e vendimit date 29.05.2018 te Keshillit te Administrimit te Shoqates.
- BAZA LIGJORE:** Kodi Civil, Ligji Nr.8788, date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimpruese”, Ligji Nr.8789, date 07.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jofitimpruese”.

Gjykata, ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te kerkeses dhe te akteve bashkelidhur saj;

V E R E N

1. Me kerkesen drejtuar kesaj Gjykate, kerkuesi Erlir Puto, cilesine e Drejtorit te Pergjithshem te Shoqates “Agjencia Albautor”, kerkon depozitimim e vendimit date 29.05.2018 te Keshillit te Administrimit te Shoqates “Agjencia Albautor”.

Nga provat shkresore te paraqitura nga ana e pales kerkuese dhe aktet e depozituara ne Gjykate, rezultoi e provuar se:



2. Pala kerkuese është themeluar si shoqatë e kompozitorëve, shkrimtarëve, kineastëve, botuesve, artistëve, etj regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr.5 datë 10.02.1998.
3. Me vendimin Nr.587/3, datë 30.03.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë regjistruar në regjistrin e OJF-ve vendimi Nr.1, datë 10.12.2009 i Këshillit të Ri Administrimit për zgjedhjen e Pirro Çako si President i këtij Këshilli dhe Vendimin Nr.2, datë 15.02.2010 i Këshillit të Administrimit për zgjedhjen dhe emërimin e Idar Bistri, si Drejtor Përgjithshëm i Agjencisë Albautor.
4. Në datën 07.02.2015, Asambleja e Përgjithshme e Shoqates, ka vendosur miratimin e Këshillit të Ri të Administrimit të të përbërë nga 5 anetarë: Eriona Rushiti, Erida Ibrahim Luan Zhegu, Sokol Marsi dhe Elton Deda. Ky Këshill, në datën 17.03.2015, ka vendosur miratimin e votim të fshehtë dhe unanim, emërimin e Presidentit të ri të Agjencisë Albautor Elton Deda dhe zgjedhjen e Drejtorit të ri të saj, Elir Puto.
5. Me vendimin Nr.587/4, datë 14.04.2015 dhe vendimin Nr.587/5, datë 24.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është bërë depozitimi i vendimit datë 07.02.2015 të Asamblesë së Përgjithshme të Agjencisë, për zgjedhjen e Këshillit të Administrimit, dhe depozitimi i vendimit datë 17.03.2015 të Këshillit të Administrimit të Shoqatës "Agjencia Albautor", për emërimin e Presidentit dhe të Drejtorit.
6. Për këto vendime anetari Idar Bistri, në cilësinë e ish Drejtorit të Përgjithshëm, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me të cilën ka kërkuar deklarimin e pavlefshëm të vendimeve dhe prishjen me nënvizim të regjistrimit të bërë në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, me vendimin Nr.587/4, datë 14.04.2015 dhe vendimin Nr.587/5 datë 24.04.2015.
7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr.4315, datë 23.05.2016 ka vendosur miratimin e padisë. Kundër këtij vendimi, është bërë ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.
8. Nderkohe, me vendimin Nr.587/7, datë 23.02.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës për depozitimin e vendimit Nr.3, datë 20.10.2016, për zgjedhjen e anetareve të Këshillit të Administrimit Agim Doçi, Elton Deda, Sokol Marsi, Erjona Rushiti dhe Etrita Ibrahim, konstatimin e mbarimit të mandatit të anetarit, shtimin e anetaresisë, ndryshim statuti etj.
9. Në vijim, me vendimin Nr.587/8, datë 19.01.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur pranimin e kërkesës për depozitimin e vendimit datë 20.09.2017 me të cilin

është vendosur ndryshimi i selise, miratimi i statutit, mbarimi i anetaresise, shtim i anetaresise etj.

10. Me vendimin Nr.836, date 28.05.2018 te Gjykates se Apelit Tirane (vene ne dispozicion te kesaj Gjykate me date 26.06.2018) është vendosur ndryshimi i vendimit Nr.4315, date 23.05.2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane, dhe pranimi i padise se anetarit Idar Bistri, duke deklaruar te pavlefshem vendimin Nr.1, date 07.02.2015 te Asamblese te Pergjithshme te Shoqates dhe vendimit date 17.03.2015 te Keshillit te Administrimit per emerimin e Presidentit dhe zgjedhejn e Drejtorit, dhe duke prishur me nenvizim regjistrimet e bëra në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, me vendimin Nr.587/4, date 14.04.2015 dhe me vendimin Nr.587/5 datë 24.04.2015.

11. Me date 29.05.2018, rezulton se është mbledhur Keshilli i Administrimit i Shoqates me te cilin është vendosur emerimi i Elton Deda si president dhe perfaqesues dhe Erlir Puto si Drejtor i Pergjithshem dhe thirrjen e Asamblese se Jashtezakonshme ne date 04.06.2018 etj. Ky vendim është objekt depozitimi me kerkesen e paraqitur ne Gjykate me date 04.06.2018.

12. Nga sa me lart, Gjykata arrin ne perfundimin se kerkesa e paraqitur per depozitim e vendimit date 29.05.2018 Keshillit te Administrimit nuk gjen mbeshtetje ne aktet bashkelidhur, pasi rezulton se me vendimin Nr.836, date 28.05.2018 te Gjykates se Apelit Tirane, i cili është i detyrueshem per gjykaten me te ulet, është vendosur detyrimi i Asamblese se Anetaresive te Shoqates per t'u rimbledhur sipas statutit dhe te zgjedhe organet e reja drejtuese ekzekutive te shoqates si dhe te riparoje pasojat e paligjshme qe mund te jene shkaktuar pas vitit 2015.

13. Sipas ketij vendimi pala kerkuese duhet te saktesoje numrin e anetaresive qe jane pranuar rregullisht ne baze te ligjit me vendime te ligjshme te asamblese te te gjithë anetaresive (te cilet jane pranuar me vendime te depozituara rregullisht ne regjistrin e Gjykates – skeden perkatese te regjistrimit me gjeneralitete te plota), duke filluar qe nga viti i regjistrimit fillestar ne Gjykate, duke zbritur anetaret qe nuk jetojne. Asambleja qe duhet te marre vendime te rregullta duhet te konsituohet nga te gjithë keta anetare dhe te mblidhet dhe te marre vendime te vlefshme, ne baze te parimit te se drejtes se votes se barabarte te te gjithë anetaresive te pranuar, sipas nenit 46 te Kodit Civil (pabarazia e votave është e pavlefshme, pavaresisht parashikimeve ne statut).

14. Po keshtu, ne baze te vendimit te Gjykates se Apelit, ne rast se zbatimi i ketyre urdherimeve te tij është i pamundur, atehere shoqata duhet te priset dhe kaloje ne likuidim dhe te çregjistrohet me kerkesa te personit te interesuar.



15. Sa me lart, Gjykata arrin ne perfundimin se deri ne rregullimin e situates se saj juridike perputhje me vendimin e formes se prere Nr.836, date 28.05.2018 te Gjykates se Apelimit Tirane, Kodin Civil, ligjin Nr.8788, date 07.05.2001 "Per organizatat jofitimprurese" e ligjin Nr.8789, date 07.05.2001 "Per regjistrimin e organizatave jofitimprurese", Shoqata "Agjencia Albautor" nuk mund te kryeje asnje depozitim te vendimeve te organeve te vendimmarrese ne regjistrin e organizatave jofitimprurese.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenet 24-53/1 te Kodit Civil, ligji Nr.8788, date 07.05.2001 "Per organizatat jofitimprurese", ligji Nr.8789, date 07.05.2001 "Per regjistrimin e organizatave jofitimprurese";

VENDOSI

1. Mospranimin e kerkeses se Shoqates "Agjencia Albautor", si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Shpenzimet gjyqesore jane ne ngarkim te kerkuesit.
3. Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 diteve nga dita e neserme e njoftimit te vendimit ne Gjykatën e Apelit Tirane.

U shpall ne Tirane, me date 26.06.2018

**GJYQTARE
MARINELA OSMANI**

